

S T A T U T I

korrik, 2019

Rr. "Shën. Kirili dhe Metodi, nr.54, 1000 Shkup

tel. (02) 3296 466

Në bazë të nenit 28, paragrafi 8 dhe paragrafi 10 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), ndërsa në lidhje me Amendamentin XXXIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr. 6/19) dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr. 7/19), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), në seancën e mbajtur më _____, sollti

STATUTIN

e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Ky Statut rregullon organizimin, udhëheqjen dhe procedurën për miratimin e akteve të përgjithshme dhe ndryshimin dhe plotësimin e tyre, si dhe çështjeve të tjera që janë në kompetencë të Komisionit.

Neni 2

(1) Komisioni është organ i pavarur shtetëror me cilësi të personit juridik dhe është i pavarur në punën e tij dhe në marrjen e vendimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.145/10, 136 /11, 41/14, 53/16 dhe 83/18).

(2) Komisioni për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe më së voni deri më 31 mars paraqet raport për punën e tij.

(3) Selia e Komisionit është në Shkup, rr. “Shën Kirili dhe Metodij” nr 54

Neni 3

(1) Emri i Komisionit: Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës

(2) Emri i shkurtuar i Komisionit: KMK

(3) Emri i Komisionit në gjuhën angleze: Commission for Protection of Competition

(4) Emri i shkurtuar i Komisionit në anglisht: CPC

(5) Emri i Komisionit medoemos duhet të jetë i vendosur në ndërtesë në të cilën gjendet selia e tij

Neni 4

(1) Komisioni ka një vulë të rrumbullakët të shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj dhe stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila përmban tekstin e mëposhtëm : Republika e Maqedonisë së Veriut, Shkup, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës.

- (2) Komisioni ka një vulë pranuese në formën e drejtkëndëshit të shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, që përmban tekstin në vijim: Republika e Maqedonisë së Veriut, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës - Shkup, pranuar, njësia organizative, numri, shtojca dhe vlera.
- (3) Komisioni ka një vulë dalëse në formën e drejtkëndëshit të shkruar në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, që përmban tekstin vijues: Republika e Maqedonisë së Veriut, Shkup, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës.



- (4) Komisioni ka këtë embleme

Neni 5

- (1) Porositja , përdorimi dhe ndërrimi i vulës me stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- (2) Për ruajtjen dhe përdorimin e drejtë të vulës dhe vulës drejtkëndëshe është përgjegjës kryetari i Komisionit ose personi që ai do ta caktojë.

II. UDHËHEQJA E KOMISIONIT

Neni 6

- (1) Kryetari i Komisionit i kryen detyrat si në vijim:
 - (1) përfaqëson, paraqet dhe udhëheq me punën e tij;
 - (2) është përgjegjës për zbatimin ligjor dhe efikas të punëve që janë në kompetencë të Komisionit;
 - (3) propozon masa për të përmirësuar punën e Komisionit;
 - (4) i propozon Komisionit të miratojë aktet që janë në kompetencë të tij;
 - (5) kujdeset për avancimin dhe trajnimin (përgatitjen) profesional të punonjësve në Komision;
 - (6) nënshkruan aktet, vendimet dhe materialet e tjera që Komisioni miraton, përveç atyre për të cilat ka dhënë autorizim;
 - (7) është përgjegjës për zbatimin e vendimeve në Komision;
 - (8) autorizon një person që të nënshkruajë në emër të Komisionit;
 - (9) Propozon masa për mirëmbajtjen e investimit dhe furnizimit, respektivisht për shitjen e mjeteve themelore në përputhje me planin financiar;
 - (10) nënshkruan urdhër udhëtimet (lejet e udhëtimit) për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit;
 - (11) kryen edhe punë të tjera që do të ia përcaktoj Komisioni;

- (2) Në rast mungese ose pengese, kryetarin e Komisionit e zëvendëson njëri nga anëtarët e angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit.

III. ORGANIZIMI I KOMISIONIT

Neni 7

Organizimi i brendshëm i Komisionit rregullohet me këtë Statut dhe aktet e përgjithshme që Komisioni i miraton në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligjit për Nëpunësit Administrativë.

Neni 8

Komisioni është i përbërë nga Kryetari, katër anëtarët dhe shërbimi profesional.

Neni 9

- (1) Kryetari dhe dy anëtarët e Komisionit, të cilët angazhohen profesionalisht në punën e Komisionit, përbëjnë Komisionin Vendimmarrës për Kundërvajtje.
- (2) Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje ka vulë me formë të rrumbullakët të shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila përmban tekstin e mëposhtëm: Republika e Maqedonisë së Veriut-Shkup, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës - Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje.
- (3) Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje ka vulë pranuese në formë drejtkëndëshi të shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, që përmban tekstin në vijim: Republika e Maqedonisë së Veriut - Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës - Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje Shkup, pranuar, njësia organizative, numri, shtojca dhe vlera.
- (4) Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje ka vulë dalëse në formë drejtkëndëshi të shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, që përmban tekstin në vijim: Republika e Maqedonisë së Veriut, Shkup, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje, Shkup.
- (5) Komisioni Vendimmarrës për kundërvajtje përdor emblemën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- (6) Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje nxjerrë udhëzime dhe akte të tjera të përgjithshme që janë me rëndësi për kryerjen e kompetencave të tij, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- (7) Komisioni Vendimmarrës për Kundërvajtje miraton Rregulloren e Punës, me të cilën rregullohet mënyra dhe procedura e punës dhe vendimmarrjes së Komisionit Vendimmarrës për Kundërvajtje.

Neni 10

- (1) Punët profesionale, normativo-juridike, administrative, administrativ-mbikëqyrëse, materialo-financiare, kontabilitetit, informatike dhe aktivitete të tjera të Komisionit dhe Komisionit Vendimmarrës për Kundërvajtje i kryen shërbimi profesional, me të cilin udhëheq sekretari i përgjithshëm, të cilin e emëron Kryetari i Komisionit.
- (2) Për kryerjen në mënyrë të pandërprerë, racionale dhe të suksesshme të kompetencave të shërbimit profesional, organizohen sektorë dhe njësi si forma themelore organizative.
- (3) Punën e sektorëve e drejtojnë udhëheqësit e sektorëve.

Neni 11

(1) Format themelore organizative të shërbimit të ekspertëve të Komisionit janë:

- 1) Sektori për Punë të Përgjithshme dhe Juridike
 - Njësia për Punë të Përgjithshme dhe Profesionale-Administrative
 - Njësia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- 2) Sektori për Analiza dhe Vlerësim të Përqendrimeve
 - Njësia për Hulumtim dhe Analizë të Tregut
 - Njësia për Vlerësimin e Përqendrimeve
- 3) Sektori për Procedurat Kundërvajtëse
 - Njësia për Procedurat Kundërvajtëse në Fushën e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese dhe Përqendrimeve
 - Njësia për Procedurat Kundërvajtëse në Fushën e Kontratave të Ndaluara dhe Kundërvajtjeve më të lehta të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- 4) Sektori për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore
 - Njësia e Mbikëqyrjes së Ndhmës Shtetërore
 - Njësia e Vlerësimit të Ndhmës Shtetërore
- 5) Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Monitorim dhe Zbatimin e së Drejtës së BE-së
 - Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar
 - Njësia për Monitorimin dhe Zbatimin e së Drejtës së BE-së
- 6) Njësia për Çështje Financiare

IV. AKTET E PËRGJITHSHME

Neni 12

(1) Komisioni i miraton këto akte të përgjithshme:

- 1) Statutin e Komisionit
- 2) Rregulloren për organizimin dhe punën e brendshme të shërbimit profesional të Komisionit;
- 3) Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Komisionit;
- 4) Rregulloren e punës së Komisionit;
- 5) Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar të anëtarëve të Komisionit dhe punonjësve në shërbimin profesional të Komisionit.

Neni 13

Statuti rregullon organizimin, menaxhimin dhe procedurën për miratimin e akteve të përgjithshme dhe ndryshimin e plotësimin e tyre, si dhe çështje të tjera në kompetencë të Komisionit.

Neni 14

Rregullorja për organizimin dhe punën e brendshme të shërbimit profesional të Komisionit rregullon organizimin e brendshëm, mënyrën e punës së shërbimit profesional të Komisionit, llojet e formave organizative dhe fushëveprimin e tyre.

Neni 15

Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Komisionit përcakton numrin e përgjithshëm të nëpunësve administrativ dhe personelit teknik ndihmës që nevojitet për kryerjen e kompetencave të Komisionit, titujt, emrin, përshkrimin, renditjen e vendit të punës sipas formave organizative dhe kushteve të veçanta që kërkohen për kryerjen e punëve dhe detyrave të vendeve të veçanta të punës.

Neni 16

Me Rregulloren e punës së Komisionit rregullohet mënyra dhe procedura e punës dhe vendimmarrja e Komisionit.

Neni 17

Me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe punonjësve në shërbimin profesional të Komisionit, rregullohet forma dhe përmbajta e formularit të legjitimacionit zyrtar dhe mënyra e dhënies dhe marrjes së tij.

V. PROCEDURA PËR MIRATIMIN, NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E AKTEVE TË PËRGJITHSHME

Neni 18

(1) Procedura për miratimin e akteve të përgjithshme fillon me një version të propozuar të aktit të përgjithshëm që mund të propozohet nga kryetari ose një anëtar i Komisionit.

(2) Ndryshimet dhe plotësimet e akteve të përgjithshme miratohen në mënyrën dhe procedurën e parashikuar për miratimin e tyre.

(3) Në rast paqartësie në zbatimin e dispozitave të akteve të përgjithshme, Komisioni bën interpretimin e tyre.

VI. KODI ETIK

Neni 19

(1) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit janë të detyruar t'i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë profesionale dhe të rregullt, në përputhje me dispozitat ligjore.

(2) Punonjësit në shërbimin profesional të Komisionit janë të detyruar t'i kryejnë detyrat e besuara në mënyrë profesionale dhe të rregullt, në përputhje me dispozitat ligjore dhe në suazat e urdhrave dhe udhëzimeve të marra.

(3) Punonjësit në shërbimin profesional të Komisionit janë përgjegjës për punën e tyre dhe për të gjitha veprimet që kanë ndërmarrë ose nuk kanë arritur t'i ndërmarrin në kryerjen e punës së tyre.

VII. PROGRAMIMI DHE PLANIFIKIMI I PUNËS

Neni 20

Me Planin Strategjik rregullohen misioni, qëllimet dhe prioritetet, programet për arritjen e qëllimeve dhe prioriteteve, rezultatet e arritura dhe procedurat për konsultim, ndikimi në rregullore dhe burimet njerëzore dhe zbatimi i planit.

Neni 21

Me Programin vjetor të punës përcaktohen detyrat që kryen Komisioni në kuadër të fushëveprimit të tij, të cilat rrjedhin nga funksionet e tij.

Neni 22

Në bazë të detyrave programore vjetore, Komisioni përcakton detyrat specifike, bartësit e tyre dhe afatet e realizimit.

Neni 23

Programi përcakton mënyrën e bashkëpunimit me komisionet përkatëse të vendeve të tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare.

VIII. TRANSPARENCA NË PUNË

Neni 24

- (1) Puna e Komisionit është publike.
- (2) Komisioni siguron transparencën në punën e tij përmes mjeteve të informimit publik, si dhe me njoftimin e organeve të tjera shtetërore për punën e Komisionit.
- (3) Për informimin e plotë të opinionit për punën e tij, Komisioni mund të nxjerrë në mënyrë periodike një publikim të veçantë, që do të publikohet edhe në ueb- faqen e Komisionit.

IX. FINANCIMI I KOMISIONIT

Neni 25

- (1) Mjetet për punën e Komisionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Komisioni miraton planin financiar me të cilin ndahen mjete për punën e Komisionit për një vit afarist.
- (3) Urdhërdhënës për zbatimin e planit financiar është kryetari i Komisionit.

Neni 26

- (1) Nga mjetet e Komisionit sigurohen mjete posaçërisht për: pagat dhe shtesat për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të cilët profesionalisht janë të angazhuar në punën e Komisionit dhe kompensimin për anëtarët e Komisionit që nuk janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit, pagat për punonjësit në shërbimin profesional të Komisionit, furnizimin e pajisjeve dhe shlyerjen e shpenzimeve materiale për punën e Komisionit, shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit dhe nëpunësit administrativë në shërbimin profesional të Komisionit, pjesëmarrjen në punën e organizatave ndërkombëtare, kompensimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm që nuk janë të punësuar në Komision, të cilët janë të paraparë me planin vjetor financiar për vitin aktual.

Neni 27

- (1) Pagat e kryetarit dhe të anëtarëve që angazhohen profesionalisht në punën e Komisionit caktohen në bazë të Vendimit për caktimin e koeficientit për përcaktimin e pagave, të cilin e sjell Komisioni për Çështjet e Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Shtesat e anëtarëve të Komisionit të cilët nuk janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit përcaktohen me Vendim për përcaktimin e lartësisë së kompensimeve për anëtarët e Komisionit që nuk janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit.
- (3) Pagat dhe kompensimet e pagave të punonjësve në shërbimin profesional të Komisionit përcaktohen sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Ligjin për Nëpunësit Administrativë.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

- (1) Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti , shfuqizohet Statuti me nr. 01-103/1 të datës 28.02.2012.
- (2) Ky Statut hyn në fuqi ditën ardhshme nga dita e miratimit të tij.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës
Kryetar
Dr. Владимир Наумовски